



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 21-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 29. 01. 2020, në sallën e vogël për mbledhje me fillim në ora 13⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Hyra Bytyçi, anëtare
3. Lumturije Bytyqi-Hasani
4. Albulena Kelmendi, anëtare
5. Ukë Kryeziu, anëtar
6. Afrim Miftari, anëtar
7. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Emina Rexhiq, drejtoreshë e DPU
2. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
3. Kimete Jashanica, OSBE

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës e keni marrë dhe të njëjtin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të e KPF-së.
2. Informatë për punën e KKSBB-së për vitin 2019.
3. Propozim Rregullorë mbi taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.
4. Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë.

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë përkatësisht nuk pati vërejtje as plotësime, kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja për punën e kësaj mbledhje me të gjitha votat për aprovoi:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 20-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Afrim Miftari, kam një vërejtje në faqen 3 ku duhet të shënohet te subvencionet.

Meqë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 20-të të KPF-së

Shtesë: Ekstrakti

II

Informatë për punën e KKSB-së për vitin 2019.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, tha se për këtë pikë kam propozim që të procedojmë për diskutim në Kuvend

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat për, vendosi që kjo Informatë t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

III

Propozim Rregullore mbi taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i dha fjalën Emina Rexhiqit, drejtoreshë e DPU, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ukë Kryeziu, a do të ket leje ndërtimore deri sa të kryhen hartat zonale dhe pyetja e dytë a ka mundësi me u ndryshu këto taksa.

Emina Rexhiq, pa përfundu hartat zonale nuk do të ketë leje ndërtimore, ndërsa sa i përket pyetjes së dytë ne prap do ta bijmë atë Rregullore në Kuvend.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e Rregullores dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja vendosi që me 7 vota për propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

IV

Propozim vendim për dhenien e pelqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes Daut Azemi, i dha fjalën, Shefqet Amerllahut, drejtori i DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, kam një pyetje përfituesit e subvencioneve a janë monitoruar ndonjëherë nga komuna a ka ndonjë komision i cili i verifikon pasi që ka pas informata që persona të ndryshëm i kanë shitë ose nuk kanë punuar fare me to apo edhe i kanë lëshuar

me qira. Po ashtu kam një vërejtje që propozimet kur të na vinë në Kuvend të lektorohen pasi që po kanë shumë gabime drejtëshkrimore.

Albulena Kelmendi, pajtohem edhe unë që duhet të ketë një komision për verifikimin e këtyre përfituesve po ashtu pajtohem që t'ju ndahen subvencionet sipas kërkesave të qytetarëve por shpresojmë që këto mjete kur të ndahen të jenë transparente.

Ukë Kryeziu, a janë këto mjetet e fundit që i ka drejtorati i bujqësisë apo ka edhe mjete tjera.

Tani është formuar një Komitet që ka kriju një shoqatë të bletarëve për mbështetje të bletarisë ku ai forum grumbullon mbi 100 bletarë dhe ai i adreson kërkesat dhe nevojat e bletarëve dhe këta janë duke hartuar një plan e me të cilën do të kërkojnë edhe mbështetje nga komuna. Unë edhe herën e kaluar kam thënë se një serë prej 50m² është e vogël dhe nuk mundet që të ketë produkte në treg por vetëm për nevojat familjare dhe këto sera duhet të jenë 100m².

Hyra Bytyqi, do të ishte mirë që të ketë një komision i cili do t'i monitoronte këto mjete të cilat po i ndan komuna.

Fehmi Rexhepi, kam një pyetje është mirë që bujqëve të ju ndihmohet edhe në blegtori qoftë me krerë delesh apo të dhive.

Shefqet Amerllahu, ne kemi një rast të evidentuar e të cilit i është konfiskuar mjeti i fituar ndërsa komision të veçant nuk kemi por i njëjti komision që i ka nda edhe i monitoron.

Daut Azemi, Kryesues i KPF-së, tha se në bisedë me Kryetarin dhe drejtorin është diskutu që i njëjti komision që ka qenë në ndarje të mjeteve do t'i verifikoj.

Lumturije Bytyqi-Hasani, cilat janë kriteret që duhet të jetë përfitues një person dhe a iu jepet përparësi personave me kushte më të rënda.

Shefqet Amerllahu, e kemi një Rregullore për subvencione ku ceken kushtet dhe kriteret përparësi kanë personat me kushte më të rënda. Ndërsa sa i përket blegtorisë ne si komunë kemi pasur bashkëpunim edhe me organizata tjera ku ka pasur përfitues të deleve po ashtu ka pasur edhe përfitues të bletëve.

Ukë Kryeziu, është mirë që paisjet të cilat i dhuron komua të kenë llogon e komunës dhe me këtë do të zvogëlohet keqpërdorimi.

Afrim Miftari, është mirë që po ju ndihmohet ekonomive familjare është një shumë simbolike prej 195 mijë euro dhe është mirë që po përfitojnë ekonomitë familjare dhe ne si të tillë e përkrahim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimt dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha vota për, vendosi që propozim vendimi t'i procedohet për shqyrtim Kuvendit.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14,¹⁰

***Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu***

***Kryesuesi i Komitetit
Daut Azemi***